



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKISË DIVJAKË

DREJTORIA E BUJQËSISË , MJEDISIT, MENAXHIMIT TË TOKËS DHE PYJEVE

Nr. 1970 Prot.
10

Divjakë, më 17.03.2026.

PROJEKT - VENDIM

Nr. 30, datë 17.03.2026.

**“PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT ME NUMËR 75, DATË 26.11.2025, PËR
MIRATIMIN E PROJEKTIT: “RISHIKIM I PROJEKTIT TË UJITJES ME
PRESION PËR SKEMËN E UJITJES, DIVJAKË”.**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (i ndryshuar), Kreu VII, funksionet dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes vendore, Neni 21, 22, 27, si dhe Ligji numër 24/2017, datën 9.3.2017, “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”, Udhëzimi numër 12, date 30.12.2019, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, me shkresën e ardhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me numër 4866 prot, datë 02.07.2025, protokolluar nga institucioni ynë, me numër 6214 prot, datë 04.07.2025, si dhe shkresa e Minsitrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretari i Përgjithshëm, me numër 4866/1 prot, datë 19.09.2025, protokolluar nga Institucioni ynë me numër 10162 prot, datë 22.09.2025, si dhe bazuar ne shkresën me numer 849 prot, date 27.01.2026, protokolluar nga Institucioni yne me numer 855 prot, date 29.01.2026, i propozojme Keshillit të Bashkisë Divjakë, me datë 30.03.2026:

1. Të miratojë një ndryshim të vendimit me numër 75, datë 26.11.2025, për miratimin e projektit: “Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes, Divjakë”.

a. Emërtimet ishin:

- Të miratojë projektin: “Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes, Divjakë”, me këto kushte:
Ministria përkatëse të marrë masa bashkëpunimi me zbatuesit e projektit për filtrimin e ujërave që grumbullohen në Emisarin e Tërbufit, nga derdhja e ujërave të ndotur nga fshatrat: Dushk i Madh, Çermë Sektor, Grabjan dhe Shënepremte.
Projekti: “Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes, Divjakë”, të sigurojë presion ujitje që të mbulojë të gjithë sipërfaqen e planifikuar për vaditjen e tokave.

b. Emërtimet bëhen:

Projekti: “Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes, Divjakë”, të sigurojë presion ujitje që të mbulojë të gjithë sipërfaqen e planifikuar për vaditjen e tokave.



2. Për zbatimin e këtij projekt - vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë , Veterinarisë, Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Infstrukturës.

Drejtoria e Bujqësisë ,Mjedisit, Menaxhimit te Tokes dhe Pyjeve
Dhimitër Kruti

Përgjegjëse e Sektorit Ujitje dhe Kullim
Josif Kruti

JURISTI
Andi Bullari

KRYETARI
JOSIF GORREA

